



Përkthimi ndërkulturor në shkollë

Informacion për prindër

Të dashur prindër

Në shkollën fillore bashkëpunimi i prindërve është shumë i rëndësishëm. Ju mund ta përkrahni fëmijën tuaj më së miri, nëse merrni pjesë aktivisht në bisedat në shkollë. Por temat dhe situatat shkollore janë shpesh të komplikuar. Përkthimi ndërkulturor mundëson komunikimin ndërmjet shkollës dhe prindërve me njohuri të pakta deri të mesme të gjuhës gjermane.

Kush janë përkthyesit ndërkulturor?

Përkthyesit ndërkulturor janë të kualifikuar veçanërisht për këtë detyrë dhe kanë njohuri të mira të gjuhës gjermane dhe të një gjuhe tjetër. Ata përkthejnë bisedën plotësisht dhe në mënyrë korrekte ndërmjet mësuesit dhe jush. Përkthyesit ndërkulturor i dinë dallimet ndërmjet sistemit shkollor në Zvicër dhe vendit prej nga ju vini. Kështu ata mund t'ju sqarojnë juve dhe personelit mësimit në mënyrë të kuptueshme të përbashkëta dhe dallimet e dy sistemeve shkollore. Përkthyesit ndërkulturor janë neutral dhe i nënshtrohen detyrimit për heshtje.

Kur rekomandohet prezenca e një përkthyesi ndërkulturor?

Për bisedat e rëndësishme në shkollë, ju ose mësuesi mund të propozoni një përkthyes ndërkulturor – kjo rekomandohet veçanërisht në situatat në vijim:

- Hyrja në kopshtin për fëmijë dhe në shkollën fillore
- Biseda prindërore për nivelin mësimor dhe për përkrahjen mësimore të një fëmije
- Biseda për dëftesat
- Vendime për karrierën shkollore (vendime për kalimet dhe promovimet)
- Biseda shkollore ndërmjet personelit mësimit dhe prindërit dhe tek masat e veçanta përkrahëse
- Pyetje të rëndësishme për mësim dhe edukim
- Biseda për zgjedhjen e profesionit të një të reje/të riu

Përkthyesit ndërkulturor porosin për shërbimin e tyre e marrin nga drejtoria e shkollës dhe paguhen nga komuniteti shkollor.

Informacione tjera të rëndësishme për prindërit

- Në faqen e internetit të departamentit për shkollat fillore (Volksschulamts) në rubrikën „International“ mund të gjeni të përkthyerat në 10 gjuhë informacione me shkrim për prindër mbi tema të rëndësishme të shkollës fillore: <http://www.vsa.zh.ch/translations>
- Për informim përshtatet gjithashtu për tu marrë edhe DVD-ja „Die Schule im Kanton Zürich“ (Shkolla në kantonin e Cyrihut) në shtëpinë botuese për librat shkollor të kantonit të Cyrihut. Materiale shtesë dhe të përkthyerat me shkrim për DVD-në ju mund ti gjeni në linkun në vijim: <http://www.vsa.zh.ch/dvd>